



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.35/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Hajriz Hoti dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 16.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. PRANOHET** e bazuar ankesa e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë (LVV), Anr.35/2025 e datës 14.01.2025, ,
- II.** Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 8,000.00 (tetëmijë) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatës fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.
- III.** Detyrohet Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 14.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, në të cilën pretendohet se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka mbajtur tubim politik në ambientet e QKMF-së në “Nëna Terezë” në Viti me 13.01.2025, përkundër se janë të ndaluara këto tubime brenda hapësirave

që shfrytëzohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet dhe agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës siç përcaktohet në kreun XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesi i ankesës kërkon që të merren masa ndaj këtij subjekti politik dhe për të cilat pretendime në ankesë thekson se posedojnë dëshmi si foto të postuara në facebook të cilat i ka bashkangjitur ankesës fotot e printuara.

Më datë 15.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 16.01.2025 në ora 09:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 16.01.2025, subjekti politik LDK e kundërshton pretendimin e subjektit politik LVV, me arsyetimin se me rastin e mbajtjes së tubimit publik në ambientet e QKMF-së në Viti, është mbajtur një tubim i tillë në përputhje me nenin 4 paragrafi 2, neni 4 paragrafi 7 dhe neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, i cili shprehimisht thotë: “Në fushatën e zgjedhjeve, nuk mund të përfshihen kategoritë e personave si në vijim: Të punësuarit në institucionet shtetërore dhe publike, gjatë orarit të rregullt të punës, përveç kandidatëve të certifikuar, me të cilët pezullojnë vendin e punës”. Po ashtu në përgjigje në ankesë thuhet se tubimi në fjalë është mbajtur pas orarit të punës, dhe se nuk e kanë penguar procesin e punës së përditshme dhe shërbimeve të caktuara, dhe kështu është në përputhje me kërkesën ligjore të dispozitës së lartcekur të Rregullores Nr. 07/2024. Gjithashtu me rastin konkret merret parasysh edhe ligji Nr. 08 L -166 për tubime publike i cili në nenin 25 të tij shprehimisht thotë: Në raste të mospajtimit të dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve të tjera që përmbajnë dispozita rreth organizimit të tubimeve dhe ngjarjeve publike, ky ligj do të këtë epërsi.

Me që ligji për Tubimet Publike ka epërsi ndaj ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në kuptimin e përmbajtjes së dispozitave rreth organizimit të tubimeve dhe ngjarjeve Publike dhe marr parasysh nga ato që u ceken më lart kërkojmë nga PZAP-i të refuzoj ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje si të pa bazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është bazuar

Paneli, ka gjetur se postimi i fotografisë dhe tekstit mbi të i postuar në llogarinë e facebook-ut të kandidatit për kryeministër nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, të ofruara si provë materiale, në ankesë të Subjektit Politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, ka vlerësuar se nga ana e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që subjekti në fjalë, me qëllim të promovimit të programit të subjektit të tyre politik, gjatë fushatës zgjedhore, në ambientet e QKMF-së, “Nëna Terezë” në Viti, ka përfshirë stafin mjekësor, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 par. 2, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet se: “*Gjatë fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga nëpunësi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik*”.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin

zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përben përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor, pra ka bërë shkelje të tilla edhe në proceset e mëparshme zgjedhore. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e pjesëtarëve të stafit dhe hapësirat e QKMF-së, "Nëna Terezë", në Viti, përben shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën e lartëcekur të rregullës zgjedhore.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, ku thuhet se Ligji për Tubime Publike, është në epërsi në raport me LZP, Paneli vlerëson se pretendimi është i pabazuar për faktin se LZP, është ligj special në raport me Ligjin për Tubime Publike dhe se ka epërsi në zbatim si në rastin konkret e po ashtu edhe gjatë fushatës zgjedhore.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 2, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nënparagrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.35/2025 më datë 16.01.2025

Kryesuesi i Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr. 10/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Gjeriq, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Ragip Namani, anëtarë të kolegjit, lidhur me ankesën e subjektit politik: Levizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë. kundër subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Sjelljes për subjektet politike, simpatizantëve dhe kandidatëve të tyre, gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09.02.2025, parashtruar kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A. nr. 35/2025 datë 16.01.2025, në seancën e mbajtur më 24.01.2025 nxjerr këtë,

A K T G J Y K I M


APROVOHET SI PJESËRISHT e bazuar ankesa e subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë.

NDRYSHOHET pjesërisht aktvendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A. nr. 35/2025 i datës 16.01.2025, në pjesën që i përket lartësisë së gjobës së shqiptuar prej 8.000.00 (tetë mijë) euro, dhe **VENDOSËT** që subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) të dënohet me gjobë prej 4.000.00 (katër mijë) euro.

REFUZOHET pjesërisht ankesa e subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr.35/2025 i datës 6.01.2025 në pjesën e mbetur, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktvendim të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) A. nr. 35/2025, datë 16.01.2025 është aprovuar si e bazuar ankesa e parashtruar më 14.01.2025 nga subjekti politik: Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, dhe subjekti politik: Lidhja



Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, është dënuar me gjobë prej 8,000.00 (tetë mijë) euro, për shkelje të Kodit të Sjelljes të subjekteve politike, simpatizantëve dhe kandidatëve të tyre, gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09.02.2025. Subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) është e obliguar që shumën e caktuar të parave ta paguajë në emër të gjobës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit.

Kundër vendimit të lartpërmendur, subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë brenda afatit ligjor, e dorëzuar me post më 18.01.2025, e pranuar në gjykatë më 21.01.2025, me propozimin që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që do të merren parasysh të gjitha rrethanat e rastit dhe të ulet shuma në emër të gjobës së shqiptuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) më 22.01.2025, në përgjigjen me shkrim ndaj ankesës së ushtruar kundër aktvendimit A.nr. 35/2025 të datës 14.01.2025, i ka propozuar Gjykatës Supreme që ankesa e subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar, duke marrë parasysh pretendimet e paraqitura ankimore, si dhe pretendimet e theksuara në përgjigjen ndaj ankesës, dhe pas këqyrjes së shkresave të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, ushtruar kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.br.35/2025, datë 14.01.2025 është pjesërisht e bazuar.

Pas këqyrjes së plotë të shkresave të lëndës, vërtetohet se Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) me datë 14.01.2025, ka pranuar ankesë nga subjekti politik Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën thuhet se subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë ka mbajtur një tubim publik politik në hapësirat e QKMF “Nënë Tereza” në Viti më 13.01.2025, përkundër faktit se këto tubime brenda hapësirave që shfrytëzohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet dhe agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë të ndaluara, siç është përcaktuar në Kapitullin XII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Në përgjigje ndaj ankesës të datës 16.01.2025. subjekt politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e kundërshtoi ankesën e parashtruar dhe të njëjtën e vlerësoi si të pabazuar, me arsyetim se tubimi lëndor publik është mbajtur në hapësirat e QKMF-së në Viti në përputhje me nenin 4, paragrafi 2 dhe paragrafi 7 dhe neni 5, paragrafi 2. nënparagrafi 1 të Rregullores



zgjedhore nr. 07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitroimi i fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimi financiar, ku shprehimisht thuhet: “Në fushatën e zgjedhjeve, nuk mund të përfshihen kategoritë e personave, si në vijim: 2.1. Të punësuarit në institucionet shtetërore dhe publike, gjatë orarit të rregullt të punës, përveç kandidatëve të certifikuar, të cilët pezullojnë vendin e punës”. Në përgjigje pretendohet gjithashtu se tubimi lëndor publik është mbajtur jashtë orarit të punës dhe se nuk është penguar procesi i punës së përditshme dhe ofrimit të shërbimeve.

Pas shqyrtimit të ankesës të parashtruar nga subjekti politik: Levizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) vendosi si në dispozitiv të vendimit të kontestuar A.nr.35/2025 të datës 16.01.2025. Në arsyetim të vendimit të tij, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ndër të tjera ka theksuar se ankesa e parashtruar është e bazuar, ngase ka vërtetuar se subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka bërë shkelje të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën Zgjedhore, monitorimin e fushatës zgjedhore dhe deklaratën financiare, në mënyrë që me qëllim të promovimit të programit të tij politik, gjatë fushatës zgjedhore, ka mbajtur një tubim publik në ambientet e QKMF-së, “Nënë Tereza” në Viti, në të cilën kanë qenë prezent personeli mjekësor, kështu që ky veprim është në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 paragrafi. 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (Ligji Nr. 08/L-228).

Sa i përket përgjigjes së subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) të njëjtën e ka vlerësuar të pabazuar, për arsyen se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (Ligji nr. 08/L. -228) është ligj i veçantë në raport me Ligjin për Tubimet Publike, dhe se ka përparësi në zbatim në rastin konkret.

Për bazën juridike të vendosjes si në dispozitiv të vendimit të kontestuar, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është thirrur në nenin 36 paragrafi 2, nenin 118 paragrafi 1, nenin 120 paragrafi 1, nënparagrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (Ligji nr. 08/L-228), lidhur me nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 2 të Rregullores nr. 01/2024 për procedurën e parashtrimit të ankesave dhe vendosjes sipas tyre.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, vlerëson se Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) me rastin e shqiptimit të gjobës ndaj subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, të rregullte dhe të drejtë, për në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e përcaktimit të lartësisë së shumës së gjobës.



Gjykata Supreme në tërësi e pranon gjendjen faktike të vërtetuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), sepse nga provat që gjenden në shkresa të lëndës, nga ankesa, si dhe nga përgjigja në ankesë, vërtetohet se janë provuar pretendimet e parashtruesit të ankesës, subjektit politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për faktin se subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka mbajtur tubim publik politik në hapësirat e QKMF-së "Nënë Tereza" në Viti me datën 13.01.2025, përkundër faktit se këto tubime brenda ambienteve që i shfrytëzon Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet dhe agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës, janë të ndaluara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, rrethanat e vërtetuara nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) janë vendimtare për shqiptimin e gjobës ndaj subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), pasi që mbajtja e tubimit zgjedhor brenda hapësirave të cilat i shfrytëzon Qeveria e Republikës së Kosovës, institucionet dhe agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës, është e ndaluar, kështu që ky subjekt politik ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 36, paragrafit 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë (Ligji Nr. 08/L-228). Mirëpo, lartësia e gjobës të cilën e ka shqiptuar Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) për shkeljen lëndore, është e lartë, andaj në atë pjesë Gjykata Supreme vendosi që të ndryshoj vendimin e kontestuar.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat faktike të vërtetuara nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), si dhe rrethanat konkrete që kanë të bëjnë me lartësinë e gjobës, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, ka qenë e nevojshme që të bëhet ndryshimi i vendimit të goditur, për shkak të natyrës së shkeljes dhe ndikimin e mundshëm minimal të saj në procesin zgjedhor, në standardet, sigurinë dhe Kodin e Sjelljes së subjekteve politike, Natyra e shkeljes është e tillë që nuk ka ndikuar në imazhin e përgjithshëm të zgjedhjeve, ngase tubimi publik është mbajtur gjatë fushatës zgjedhore, shkelja konsiston në atë se tubimi publik është mbajtur në hapësirat në të cilat kjo është e ndaluar. Ndikimi konkret i këtij tubimi publik në shkeljen e standardeve se si duhet të zhvillohet një fushatë zgjedhore është minimal dhe nuk ka ndikim në procesin e mëtejshëm zgjedhor, ndaj gjoba prej 4000.00 (katër mijë) euro është ekuivalente me të gjitha rrethanat e paraqitura.



Meqenëse nuk ka pretendime tjera ankimore, dhe për arsyet e paraqitura më lartë, dhe në përputhje me dispozitën e nenit 118, par. 4 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.NR. 10/2025, datë 24.01.2025.

Kryetare e kolegjit, gjyqtare


Milena Gjeriq

Përktheu: Drita Kelmendi



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

**SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE**


Punëtor i autorizuar
Ovlašćeni radnik